



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA  
PRISHTINË  
REPUBLIC OF KOSOVO  
PRISHTINA  
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA  
PRIŠTINA  
GOVERNMENT OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA	
INSTITUTI I HISTORISË - INSTITUTE OF HISTORY - INSTITUT ZA ISTORIJU	
Njësia Org. Org. Unit Org. Jed.	1. H
Nr. l. prot. Prot. N. Br. Prot.	01/47/26
Nr. i. Faqeve No. Pages Br. Stranica	10 fq
Data: Date: Datum:	06/03/26
PRISHTINË - A	



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI"-  
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI"-  
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI"-

Prishtinë, 06.03.2026

## RAPORTI I KOMISIONIT PËRZGJEDHËS - RECENSUES

*për zgjedhjen e kandidatit për vendin e punës:  
Bashkëpunëtor i lartë shkencor për periudhën Osmane - zgjedhje/rizgjedhje*

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013) nenet 24 dhe 35, Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" Prishtinë (01B-195, të datës 31.10.2024) nenet 21 dhe 33, nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L212, Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë dhe akteve të tjera përkatëse të Institutit, në konkursin e shpallur më datë 03.02.2026 në faqen zyrtare të Institutit të Historisë "Ali Hadri"-Prishtinë. Me vendim të Këshillit Shkencor, të datës 30.01.2026, është caktuar Komisioni për zgjedhës-recensues për vendin e punës *Bashkëpunëtor i lartë shkencor për periudhën osmane*, në këtë përbërje: Prof. Dr. Frashër DEMAJ - kryetar, Prof. Dr. Bedri MUHADRI - anëtar dhe Prof. Asoc. Dr. Orges DRANÇOLLI - anëtar.

## RECENSIONI KOMISIONIT PËRZGJEDHËS *për kandidatin*

Mbështetur në dokumentet ligjore të theksuara më sipër dhe në dosjet e dorëzuara, Komisioni ka konstatuar se në konkursin për vendin e punës *Bashkëpunëtor i lartë shkencor për periudhën Osmane - zgjedhje/rizgjedhje*, ka konkurruar vetëm kandidati, prof. ass. dr. Agron ISLAMI.

Pas verifikimit të dokumentacionit të nevojshëm të dorëzuar, të dëshmuar në CV-të përkatëse të kandidatit, Komisioni për zgjedhës ka konstatuar se kandidati i ka plotësuar kushtet formale juridike për të aplikuar për këtë vend pune.

## TË DHËNA BIOGRAFIKE DHE BIBLIOGRAFIKE PËR KANDIDATËT

1. **Agron Islami** (nr. Protokollit.01/38/26) historian - osmanist. U lind më 08.12.1982 në Gjilan. Shkollën fillore dhe atë të mesme e kreu në vendlindje. Studimet për bachelor i përfundoi në katedrën e Orientalistikës në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës. Në vitin 2010 përfundoi Masterin në Universitetin Publik Sakarya, Instituti i Shkencave Shoqërore, Fakulteti i Shkencave dhe Letërsisë Departamenti i Historisë së periudhës osmane, në Adapazar të Turqisë, me temë: “Transkriptimi dhe interpretimi i Sixhilit ë Rodosçukut nga viti 1631-32”. Ndërsa studimet e doktoratës i përfundoi në vitin 2021 në Universitetin të Stambollit, Instituti i Shkencave Shoqërore, Fakulteti i Shkencave dhe Letërsisë, Departamenti i Historisë së Periudhës osmane (Kohë e Re) me temë “Kosova gjatë shekullit XVIII: Historia socio-ekonomike”. Në Prill të vitit 2015 është përzgjedhur *Hulumtues i pavarur shkencor për periudhë osmane* në Institutin e Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, ndërsa në vitin 2021 është avancuar në titullin e *Bashkëpunëtorit Shkencor për periudhë osmane* në Institutin e Historisë “Ali Hadri”. Është autor i monografisë *Areali i Kosovës në kohën osman: një histori socio-ekonomike e shekullit XVIII*, botim i Institutit të Historisë, autor i parë i 4 vëllimeve dokumentare me epitafe me mbishkrim osman (transkriptim dhe përkthim i epitafëve) në 4 rajone të Kosovës (botim i Fakultetit të Studimeve Islame, Prishtinë); autor i kapitullit të historisë së Prishtinës (1389-1912) në vëllim II të *Prishtina në Histori: artikuj dhe perspektiva*, Përkthyes i dhjetëra dokumenteve të proveniencës osmane në lidhje me Prishtinën të botuara në *Prishtina në histori: fragmente, dokumente dhe letra 1315-1899* me editor Y. Rugova, ka të botuara punime shkencore në gjuhën shqipe, angleze dhe turke brenda periudhës që përfaqëson, si dhe pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Aktiviteti i tij edukativo-arsimor dhe ai i publikimeve është verifikuar në dosjen e dorëzuar nga ana e tij.
  
2. Punime të publikuara sipas *Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve*, përkatësisht **Shtojcës I, pika A.2.1.**, të publikuara në revista ndërkombëtare dhe kombëtare, të cilat janë të indeksuara në bazat akademike vijuese baras vlerësohen me 1 pikë:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Titulli i punimit	Revista	Vëll.nr.(viti), fq.	Linku i publikimit
1.	Agron Islami	“Avusturya Ordusunun Kosova’yı İlgali (1689-1691) ve Yerel Halkın Tepkisi/ The Austrian Armies”	<i>Journal of Balkan Studies</i>	Vol. VI/ no.1 (2026) fq. 46-66	<a href="https://balkanjournal.org/jbs/article/view/46">https://balkanjournal.org/jbs/article/view/46</a>  Platforma: EBSCO

		Occupation of Kosovo (1689-1691) and the Reaction of the Local Population			
2.	Agron Islami, Sefedin Rahimi	“Ibtidaiye Mektebs in the Kaza of Gjilan According to the Ottoman Sources During 1900-1906”	<i>Journal of Balkan Studies</i>	Vol.2, no 2, Viti 2022, fq.47-71	<a href="https://balkanjournal.org/jbs/article/view/23/23">https://balkanjournal.org/jbs/article/view/23/23</a>  Platforma: EBSCO
3	Agron Islami	“Popullsia e Kazasë së Gjilanit Sipas Regjistrimeve Osmane të Shekullit XIX-XX”.	<i>Rumeli İslam Araştırmaları/ Rumeli of Islamic Studies</i>	Nr. 5, viti 2020, fq. 69-89	<a href="https://search.worldcat.org/title/953046830">https://search.worldcat.org/title/953046830</a>  Platforma: Worldcat

-Punime të publikuara në revista kombëtare dhe botime të veçanta, të cilat janë të barazvlefshme me 0.50 pikë, përkatësisht Shtojcës I, pika A.2.2

Nr.	Emri dhe mbiemri	Titulli i punimit	Revista	Vëll.nr.(viti), fq.	Linku i publikimit
1	Agron Islami	“Vështrim mbi ekspansionet osmane në Kosovë: nga Beteja e parë (1389) deri në të dytën (1448)”	<i>Kosova</i>	50/2025	<a href="https://albanica.al/revista_kosova/article/7915">https://albanica.al/revista_kosova/article/7915</a>  Platforma: Albanica
2	Agron Islami	“Kadiu osman dhe vartësit e tij në Kosovë gjatë viteve 1700-1800”	<i>Kosova</i>	47/2023	<a href="https://albanica.al/revista_kosova/article/3696">https://albanica.al/revista_kosova/article/3696</a>  Platforma: Albanica

Pjesëmarrja në Konferencë shkencore të organizuar nga Institucioni publik kërkimor-shkencor vendor dhe ndërkombëtar të specifikuar në Shtojcën I, pika A.2.6. të barasvlershme me 0.30 pikë.

Nr.	Emri dhe mbiemri i autorit/ve	Titulli i Kumtesës	Konferenca/simpoziumi/tryeza	Organizatori	Vendi dhe viti
1	Agron Islami, Orges Drançolli	“Traces of Ottoman-Style Libraries in Kosovo: The Case of the Hadum Library”	<i>Libraries in the Ottoman World</i>	Department of Near and Middle Eastern Studies Faculty of Arts, Humanities and Social Sciences, Arts Building, Trinity College, Dublin	Dublin, Irland: 05-09 Nëntor 2025
2		“Shemsettin Sami Frashëri dhe kontributi i tij për çështjen kombëtare shqiptare gjatë viteve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit” Türk Tarih Kurumu, Ankara, 10 tetor 2025.	Tryezë Shkencore ndërkombëtare: <i>Shemsettin Sami Frashëri dhe Lëvizjet Moderne Turko-Shqiptare/ Şemsettin Sami ve Türk-Arnavut Modernleşme hareketleri,</i>	Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë & Türk Tarih Kurumu, Ankara,	Prishtinë, 10 tetor 2025
3	Agron Islami	“Profili ushtarak i Gedik Ahmed Pashës: Një kryekomandant i fushatave osmane kundër gjenovezëve dhe venedikasve (1460–1482	<i>Jeta dhe veprat e Gedik Ahmed Pashës</i>	Fondacioni Alsar, Ministria e Kulturës dhe Turzimit të Rep. së Turqisë dhe Tikës	Vlorë: Shqipëri, 06 nëntor 2025
4	Agron Islami	“Fenomeni i shndërrimit të Mesxhideve në	<i>Identitete religjioze në trojet shqiptare nga Mesjeta deri në</i>	Akademia e Shkencave e Shqipërisë	Tiranë: shtator

		Xhami në trevën e Kosovës gjatë shekujve XVII-XVIII: Një reflektim i procesit të islamizimit”	<i>rëniën e Perandorisë Osmane</i>	departamenti i Mesjetës së institutit ë historisë – Tiranë & Instituti i Historisë “Ali Hadri”- Prishtinë,	2025,
5	Agron Islami	“Pjesëmarrja vullnetare e Shqiptarëve në frontin osman gjatë Luftës së Parë Botërore”	<i>Shqiptarët dhe Lufta e Parë Botërore</i>	Instituti i Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë Instituti i Historisë-Tiranë, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti Filozofik-Departamenti i Historisë.	Prishtinë, 25 tetor 2024.
6	Agron Islami	"Aspekte politike dhe ushtarake në suaza të Krizës Lindore 1875-1878: Dhunë, shpërngulje dhe uzurpim i pasurive të shqiptarëve në sanxhakun e Nishit".	<i>Kriza Lindore 1875-1878</i>	Instituti i Historisë Ali Hadri Prishtinë	24 tetor 2025
7	Agron Islami	“Beteja e Dytë e Kosovës: Kryqëzata e fundit për shkuljen e Osmanëve nga treva e Ballkanit	<i>Lufta e Dytë e Kosovës (17-19 tetor 1448)</i>	Komuna e Obliqit-Kastriotit, Instituti Albanologjik-Prishtinë, Instituti i	Obiliq-Kastriot 20-21 Gusht 2024.

		të sotëm”		Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup	
8	Agron Islami	“XVIII. asırda Prizrenli Emine Hâtun’un Hukûk Mücâdeleleri”,	<i>Foruth European Convention on Turkic, Ottoman and Turkish Studies (Turkologentag 2023),</i>	Universiteti i Vienës/ GTOT (The Society of Turkic, Ottoman and Turkish Studies)	21-25 September, Vienn, 2023.

-Publikimet e monografive studimore, librave me dokumente, përkthimeve në fushën e kandidatit sipas të specifikuara në rregulloren për zgjedhje/rizgjedhje, **shtojca II, pika A.**

Nr.	Autori/autorët	Titulli	Lloji i Botimit	Botuesi	Vendi dhe viti
1	Agron Islami	<i>Areali i Kosovës në kohën osmane: një histori socio-ekonomike e shekullit XVIII</i>	Monografi	Instituti i Historisë "Ali Hadri"	Prishtinë, <b>2024</b> , ISBN 978-9951-391-00-1 (391 faqe)
2	Agron Islami-S. Selimi	<i>Epitafet në Gjuhën Osmane - Regjioni i Ferizajt- Dëshifrimi dhe Përkthimi i tyre, [Vëllimi 4]</i>	Dokumente Epigrafike	Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë	Prishtinë, <b>2023</b> , ISBN 978-9951-24-4 (328 faqe).
3	Agron Islami-S. Selimi	<i>Epitafet në Gjuhën Osmane - Regjioni i Gjilanit: Dëshifrimi dhe Përkthimi i tyre, [Vëllimi 3]</i>	Dokumente Epigrafike	Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë	Prishtinë, <b>2021</b> , ISBN 978-9951-583-19-0 (261 faqe).
4	Agron Islami- S. Selimi	<i>Epitafet në Gjuhën Osmane - Regjioni i Mitrovicës: Dëshifrimi dhe përkthimi i tyre, [Vëllimi 2]</i>	Dokumente Epigrafike	Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë	Prishtinë, <b>2019</b> , ISBN 978-9951-583-15-2 (180 faqe).
5	Agron Islam- S. Selimi-H. Ahmeti	<i>Epitafet në gjuhën osmane – Regjioni i Prishtinës: Dëshifrimi dhe përkthimi i tyre, [Vëllimi 1]</i>	Dokumente Epigrafike	Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë	Prishtinë, <b>2017</b> , ISBN 978-9951-583-08-4 (123 faqe).

-Publikimet nga sesionet, konferencat, simpoziumet, tryezat shkencore në nivel ndërkombëtar, të specifikuara në **Shtojcën II, pika B.**

Nr.	Autori	Titulli i punimit	Konferenca	Botuesi dhe vendi	Vëllimi, faqet
1	Agron Islami	"Disa vendime të Divanit Osman për ruajtjen e rendit"	<i>Akte të Kuvendit Ndërkombëtar</i>	Tiranë: Akademia e Shkencave	Arkeologji dhe historik. 583-591 faqe.

		publik në Kosovë gjatë shek. XVIII”	<i>të Studimeve Albanologjike</i>	Shqipërisë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2022	
2	Agron Islami	“Pjesëmarrja vullnetare e Shqiptarëve në frontin osman gjatë Luftës së Parë Botërore”	<i>Shqiptarët dhe Lufta e Parë Botërore</i>	Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2025	Faqe 207-2018

-Prezantime gojore-shkencore në Universitete si ligjërues i ftuar, e specifikuar në Shtojcën II, Pika C.

Nr	Ligjërues	Titulli i Ligjëratis	Organizator	Vendi
1	Agron Islami	“Trashëgimia Osmane në Kosovë”	Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti Filozofik-Departamenti i Historisë	Fakulteti Filozofik, 01 dhjetor 2025, Prishtinë.

-Recensues në botime monografike dhe dokumente të specifikuara në Shtojcën II, Pika C, 1.2.

Nr.	Kontributi	Autori i librit	Titulli i librit	Vendi dhe viti
1	Recensent	Selim Daci	<i>Veprimtaria Ekonomike e Qyteteve të Kosovës në Mesjetë Shekujt XII-XV</i>	Prishtinë, 2025
	Recensent	Orges Drançolli	<i>Xhamitë me Kube në Kosovë</i>	Prishtinë, 2023
			<i>Varrezat me mbishkrime arabo-osmane në Tivarin e Vjetër</i>	Tivar, 2022
	Recensent	Ali Bardhi	<i>Varrezat e Xhamisë së Nizamëve dhe Varreza e Vjetër e Tuzit me mbishkrim Arabo-Osman</i>	Tuzi, 2020
	Recensent	Ali Bardhi	<i>Varrezat me mbishkrime arabo-osmane në Ulqin: zona e brendshme e qytetit dhe rrethina e afërt</i>	Ulqin 2019
	Recensent	Ali Bardhi	<i>Varrezat me mbishkrime arabo-osmane në Anën e</i>	Ulqin, 2016

-Redaktorë, recensues, anëtarë redaksie në revista akademike dhe shkencore të specifikuara në Shtojca II, Pika C, 1.3.

Nr.	Kontributi	Emri i Revistës	Vendi	Linku
1	Bord editorial	<i>Vakanuvis- International Journal of Historical Researches,</i>	Sakarya, Türkiye	<a href="https://dergipark.org.tr/en/pub/vakanuvis/board">https://dergipark.org.tr/en/pub/vakanuvis/board</a>
2	Bord Këshillues	<i>Sinop University Journal of Social Sciences,</i>	Sinop, Türkiye.	<a href="https://dergipark.org.tr/en/pub/sinopusd/board">https://dergipark.org.tr/en/pub/sinopusd/board</a>
3	Bord Redaktues	<i>Journal of Balkan Studies/Revista për Studime Ballkanike JBS</i>	<i>Shkup- Maqedoni e Veriut.</i>	<a href="https://balkanjournal.org/jbs/about/editorialTeam">https://balkanjournal.org/jbs/about/editorialTeam</a>

Kandidati është i angazhuar në hartimin e njësisë të veçanta në Vëllim III të projektit në realizim e sipër “Histori e Shqiptarëve (Periudha osmane) e drejtuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, si dhe në shkrimin e zërave në Enciklopedinë Shqiptare e drejtuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës (ASHAK) dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë (ASHSH).

## KONKLUZION

Mbështetur në dokumentacionin e nevojshëm dhe kushtet e konkursit, të shpallur më datë 03.02.2026, sipas Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore – Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), nenet 24 dhe 35, Statutit të Institutit të Historisë “Ali Hadri” Prishtinë (01B-195, të datës 31.10.2024) nenet 21 dhe 33, nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L212, Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë dhe akteve të tjera përkatëse të Institutit “Ali Hadri”, Komisioni përzgjedhës – Recensues, konstaton me sa vijon:

Marrë parasysh të gjitha rezultatet e punës shkencore, përgatitjen adekuate mbi periudhën e kërkuar në konkurs, punimet shkencore të fushës përkatëse të botuara në revista relevante, kontributet shkencore, pjesëmarrjen në aktivitete, konferenca e tryeza shkencore brenda e jashtë vendit, botimit të monografisë, botimit të vëllimeve me dokumente si dhe bashkëpunimeve në botimin e dokumenteve, Komisioni përzgjedhës - Recensues ka arritur në përfundimin se kandidati Agron ISLAMI ka të arritura dhe

kontribute të profilizuara mbi periudhën e caktuar, kualifikimin dhe përvojën e duhur, që i mundësojnë ushtrimin me kompetencë të pozitës së kërkuar me konkurs, gjegjësisht pozitën për *bashkëpunëtor i lartë shkencor për periudhë osmane*.

### PROPOZIM

**Komisioni Përzgjedhës - Recensues**, bazuar në kushtet e konkursit, kriteret ligjore dhe të arriturat profesionale, për vendin e punës **Bashkëpunëtor i lartë shkencor për periudhë osmane**, të Institutit të Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë, propozon kandidatin prof. ass. dr. Agron ISLAMI.

**Komisioni Përzgjedhës - Recensues:**

Akad. Frashër DEMAJ, *kryetar*

Prof. dr. Bedri MUHADRI, *anëtar*

Prof. asoc. dr. Orges DRANÇOLLI, *anëtar*